



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 37

Prishtinë, më 8 tetor 2018, në orën: 10 :00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Jasmina Zhivkoviç, Valon Ramadani, Adem Mikullovi, Imet Rrahmani, Arban Abrashi, Xhevahire Izma, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, RTK-Radio, KTV.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-097 për Transmetuesin Publik të Kosovës;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-111 për pagat në sektorin publik;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe agjencive të pavarura;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-097 për Transmetuesin Publik të Kosovës

Nait Hasani, tha se për këtë pikë të rendit të ditës, debati ka përfunduar në mbledhjen e kaluar, por megjë për votim nuk ka pasur kuorum, kjo ka qenë arsyeja e vazhimit të mbledhjes me

rendin e njëjtë të ditës. Ai tha se me të gjitha vërejtjet për projektligjin në fjalë, komisioni është në procedurën e votimit.

Konstatim: me 5 (pesë) vota “Për” dhe 1 (një) “Abstenim”, komisioni miratoi në parim projektligjin dhe nxori:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-097 për Transmetuesin Publik të Kosovës.
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputeti, Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional shqyrton projektligjin në parim, para leximit të parë në mbledhje plenare dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime për miratim në parim.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit nr. 06/L-097 për Transmetuesin Publik të Kosovës, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-111 për pagat në sektorin publik

Nait Hasani, kërkoi nga anëtarët e komisionit që ta votojnë projektligjin.

Shqipe Pantina, tha se projektligji, sidomos te tabelat e pagave, duhet të plotësohet, për arsye se projektligji favorizon pozitat politike, pastaj radhitja e pozitave duhet të ndryshohet, gjithashtu edhe te pagat e gjyqësorit, kërkohet nivelim në pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Xhevahire Izmaku, u deklarua se do të votojë projektligjin, me të gjitha vërejtjet, në mënyrë që ato të plotësohen në fazën e amendamentimit të projektligjit.

Imet Rrahmani, tha se ka dallime në pagat e mjekëve, sidomos specialistëve, duke theksuar se në procedurat e amendamentimit, komisionin e pret një punë e vështirë.

Konstatim: Komisioni, unanimisht, votoi për miratimin në parim të projektligjit dhe nxori:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-111 për pagat në sektorin publik.
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputeti, Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional shqyrton projektligjin në parim, para leximit të parë në mbledhje plenare dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime për miratim në parim.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit nr. 06/L-111 për pagat në sektorin publik, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe agjencive të pavarura

Konstatim: Komisioni, unanimisht, votoi për miratimin në parim të projektligjit dhe nxori:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të agjencive të pavarura.
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputeti, Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional shqyrton projektligjin në parim, para leximit të parë në mbledhje plenare dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime për miratim në parim.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të agjencive të pavarura, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë

Konstatim: Komisioni, unanimisht, votoi për miratimin në parim të projektligjit dhe nxori:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë.
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputeti, Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional shqyrton projektligjin në parim, para leximit të parë në mbledhje plenare dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime për miratim në parim.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

6. Të ndryshme

Komisioni diskutoi lidhur me mandatin e agjencive të pavarura, të cilat bien në fushëveprimin e komisionit. Gjatë diskutimit, anëtarët e komisionit propozuan që të gjithë kandidatët që aplikojnë për pozita të agjencive, para se të intervistohen nga komisionet përkatëse të Kuvendit, të sjellin dëshminë nga Agjencia Kundër Korrupsionit, se për pozitën për të cilën aplikon, nuk ka konflikt interesi.

Pas diskutimit dhe shqyrtimit të mandateve të anëtarëve të agjencive të pavarura dhe identifikimet lidhur me mandate, nxori:

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, të bëjë shpalljen e konkursit për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Arsyetim

Kuvendi i Kosovës, në pajtim me nenin 10.2 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bën shpalljen publike për aplikim për 4 (katër) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Komisioni Parlamentar për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, pasi ka shqyrtuar mandatet e agjencive të pavarura, të cilat bien në fushëveprimin e komisionit, vendosi që të nxjerrë rekomandim për shpalljen publike për aplikim për 4 (katër) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, 3 (tre) anëtarë nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar dhe 1 (një) anëtar nga radhët e komuniteteve tjera jo shumicë.

Mbledhja përfundoi në orën:11:15.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Nait Hasani